




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

**VENDIM**

**Nr.19, datë 30.10.2024**



**MBI KORIGJIMIN E GABIMIT NË VENDIMIN NR.3  
DATË 21.2.2024 DHE LEJES ME NR SERIE 000141 “PËR  
PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOËKËSOR PËR QËLLIME TË  
NDRYSHME”  
SUBJEKTIT “YURA CORPORATION ALBANIA C” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr. 550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me konçesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, si dhe pikën 1 e 2, neni 112, të Kodit të Proçedurave Administrative “Korrigjimi i gabimeve materialeve në aktin administrativ” I. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ. 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njehsuar të tij. Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin-Seman pasi konstatoi se pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e gabimit material, Këshilli i Basenit Ujor Seman,.

**V E N D O S I:**

1. Korigjimin e gabimit në vendimin nr.3 datë 21.2.2024 dhe lejes me nr serie 000141 “Për përdorim burimi ujor nëntoëkësor për qëllime të ndryshme (sanitare)”:

Vendndodhja e pikës së përdorimit (KRGJSH)

Nga: X= 461831.59; Y= 4508969.76.1; Z= 88 m.m.n.d

Në: = 461831.59; Y= 4508969.76.1; Z= 15 m.m.n.d

2. Asnjë trgues tjetër nuk ndryshon përveç gabimit material..
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit te subjektit te interesuar.

**KRYETARI I KBU SEMAN**

**MBARIME ISUFAJ**

